




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Puniljeno/Prodato Received/Delivery	22.12.2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMST/CK	6295/2021		1/4



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.958/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca -kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.1424/2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.164/2020 të datës 19.06.2020 ,të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit/Policia e Kosovës, në çështjen juridike „kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 22.12.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.164/2020 e datës 19.06.2020, e parashtruar nga ankuesja**

**II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër 72-KA-2020 i datës 01.04.2020 i Komisionit për Ankesa në Policinë e Kosovës.**

**A r s y e t i m**

Ankuesja e punësuar në Policinë e Kosovës, me datë 19.06.2020, ka parashtruar ankesë me numër protokoli 1200/2020, të regjistruar me numër A.nr.164/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokoli me numër 72-KA-2020 të datës 01.04.2020 të Komisionit për Ankesa në Policinë e Kosovës, i pranuar nga ankuesja me datë 18.06.2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë

03.08.2020 ka dorëzuar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses në Policinë e Kosovës. Këshilli me datë 09.07.2020 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e lëndës.

Në mungesë të kuorumit për vendosje në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankuesja të njëjtën kohë ka hapur edhe konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, përmes Aktgjykimit A.nr.1424/2020 ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoje dhe të vendos për ankesën e datës 19.06.2020 të parashtruar nga ankuesja

*Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokollit 1200/2020, të regjistruar me numër A.nr.164/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën; Vendimin e datës 13.12.2019; Ankesën e datës 23.12.2019, drejtuar Komisionit për Ankesa; Vendimin me numër protokollit 03/02-39 të datës 28.01.20120 të Komisionit për Ankesa në Policinë e Kosovës; E- mailin e datës 1.02.2020; Ankesën e datës 06.03.2020, drejtuar Komisionit për Ankesa; Vendimin me numër protokollit 03/02-135/20 të datës 01.04.2020 të Komisionit për Ankesa; Kontratën e punës; Njoftimin e datës 03.08.2020; Aktgjykimin e datës 19.11.2020, A.nr.1424/2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamentit për Çështje Administrativ; Përgjigjen në ankesë të datës 15.07.2020, me numër protokollit 1370/2020.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi shqyrtimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e pazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesja sipas Kontratës së Punës me numër 07/1-01A/0700 të datës 05.08.2014, ka qenë e emëruar në pozitën e punës "Përkthyes" në kuadër të Departamentit për Kufi, me pagë fikse prej 407.55 euro, ndërsa me Vendimin me Nr.reference 07/1-01A/1707 të datës 13.02.2019, e njëjta është sistemuar për kohë të pacaktuar në pozitën e punës Përkthyes - serbisht - shqip dhe anasjelltas në kuadër të Sektorit të Përkthimeve pranë Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme, me pagë në vlerë prej 423.85 euro dhe shtesë në pagë prej 25.00 euro.

E pakënaqur me këtë vendim ankuesja me datë 23.12.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin e Ankesave të Policisë së Kosovës, më kërkesën që të anulohet Vendimi për sistemim të përkohshëm i datës 13.02.2019 ose i njëjti të rishqyrtohet ashtu që ankueses t'i aprovohet koeficienti i pagës në nivelin e Zyrtarit të lartë të Përkthimeve dhe t'i kompensohet diferenca e pagës për tri vite në mënyrë retroaktive.

Komisioni i Ankesave i Policisë së Kosovës, me Vendimin me numër protokollit 03/02-39 të datës 28.01.2020 ka aprovuar pjesërisht ankesën e ankueses dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim në Drejtorinë e Personelit të Policisë së Kosovës.

Drejtoria e Personelit me datë 21.02.2020, ka njoftuar ankuesin se në zbatim të Vendimit të Komisionit të Ankesave ka parashtruar kërkesë në Ministrinë e Administratës Publike që të aprovoj koeficientin e pagës të njëjtë me pozitë të njëjtë në institucionet tjera të shërbimit civilë,

duke shtuar se derisa sa nuk ka aprovim nga kjo Ministri përgjegjëse, Policia e Kosovës nuk mund të vendos lidhur me ndryshimin e koeficientit.

Ankuesja serish me datë 06.03.2020, parashtron ankesë në Komisionin e Ankesave të Policisë së Kosovës, i cili me Vendimin me numër protokolli 03/02-135/20 të datës 06.04.2020 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar.

Ankuesja, brenda afatit ligjor ushtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se vendimi i ankimuar është i padrejtë dhe në kundërshtim me vendimet e me hershme të këtij Komisioni i cili për çështje të njëjtë ka vendosur ndryshe duke ju referuar Vendimit me nr.425-KA-2019 të datës 28.01.2020, kërkon që Këshilli ta aprovoj ankesën si të bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankueses ju referuar dispozitave të Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 3 paragrafi 1 ku është përcaktuar se: *1. E drejta e nëpunësve civilë për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil*, ndërsa neni 9 paragrafi 1 i po këtij Ligji përcakton se: *Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara me aktin e kantatës së punës*, dhe rrjedhimisht konstatoje se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësi civil gëzon të drejtën e realizimit të pagës të përcaktuar në aktin e themelimit të marrëdhënies së punës. Andaj, mbi këtë bazë ligjore si dhe duk marr parasysh se ankuesja sipas Vendimit me numër 07/1-01A/1707 të datës 13.02.2019 është sistemuar në pozitë të njëjtë ashtu siç ka qenë e përcaktuar me Kontratën e Punës me numër 07/1-01A/0700 të datës 05.08.2014, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankueses për sistemim në pozitën e punës Zyrtare e lartë e Përkthimeve është i pa bazuar. Rrjedhimisht, në shkresa të lëndës Kolegji, nuk ka gjetur ndonjë kontratë apo akt tjetër administrativ të organit të punësimit përmes të cilës ankueses i është njohur pozita e Zyrtares se lartë të Përkthimeve, siç pretendon e njëjta, kështu pretendimi ankimor për anulimin e Vendimit me numër 07/1-01A/1707 të datës 13.02.2019 dhe rrjedhimisht Vendimit me numër 72-KA-2020 të datës 01.04.2020 të Komisionit për Ankesa në Policinë e Kosovës, si dhe kompensimi i diferencës se pagës në mënyrë retroaktive është i pa bazuar.

Kolegji po ashtu gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se Organi i punësimit gjegjësisht Policia e Kosovës, duke ju referua dispozitave të nenit 7 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, ka bërë kërkesë pranë ministrisë përgjegjëse për administratë publike, lidhur me ngritje e koeficientit të pagës për disa pozita të punës duke përfshi edhe pozitës e ankueses, por që një kërkesë e tillë nuk është shqyrtuar nga kjo e fundit.

Andaj, bazuar si me lartë Kolegji konstaton se Komisioni për Ankesa i Policisë së Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit numër 72-KA-2020 të datës 01.04.2020, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejte ligjin material duke vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit

Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.958/2021

  
Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

  
Jeton KOCA

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së